



PROFILI I COMPANISË



FMI

Trade & Construction

www.fmi.al



PËRMBAJTJE


Prezantim	4
Qasja ndaj Biznesit	6
Vizioni dhe Vlerat	8
Misioni dhe qëllimet tona	8
Objektivat ndaj konsumatorit	
Objektivat orientuar procesit të brendshëm	
Filozofia	8
Ndikimi në mjedis	9
Gjurma gjeografike	9
Cilësi nga fillimi në fund	9
Shërbimet	10
Projektet tona	11
Produktet tona	11
Stafi ynë	12
Organograma	

PREZANTIM I FMI

FMI TRADE & CONSTRUCTION

Fmi Trade & Construction sh.p.k u themelua në vitin 2013, në një treg pothuajse të konsoliduar të Shqipërisë. Megjithëse industria shqiptare e ndërtimit në kohën e themelimit të kompanisë ishte shumë konkurruese, Fmi Trade & Construction sh.p.k shume shpejt u afirmua si një nga kompanitë më serioze dhe progressive.





Fmi Trade & Construction sh.p.k filloi rrugëtimin si lider në fushën e saj dhe vazhdon të ruajë pozicionin si një nga kompanitë udhëheqëse më të mëdha në fushën e ndërtimit. E gjithë kjo është arritur me punë

të vazhdueshme, me anë të politikave progresive dhe me anë të një planifikimi të mirë të zgjerimit të kompanisë. Ne gjithë këto vjet ne nuk kemi ulur në asnjë moment ritmin e punës në mënyrë që kompania të afirmohet si udhëheqëse e fushës së saj - një titull i cili është arritur nëpërmjet integritetit, besueshmërisë së fituar tek klientët dhe profesionalizmit në të gjitha drejtimet.

Drejtimi i kompanisë me mendje të hapur dhe në mënyrë aktive ka çuar në ndjekjen e politikave të mira të qeverisjes, si dhe në punësimin e personave të kualifikuar. Duke patur një organizim të mirë dhe infrastrukturën e duhur, menaxhmenti ka qenë në gjendje të promovojë dhe implementojë praktikën e fundit në fushën e industrisë së ndërtimit, për të krijuar një kompani që sot është lider



në fushën e saj. Ne jemi të përkushtuar për të përmbushur standardet më të larta etike dhe profesionale, në harmoni me parimet e qëdrueshmërisë sociale, ekonomike dhe mjedisore. E gjithë kjo arrihet nëpërmjet vëmendjes të vazhdueshme ndaj detajeve dhe një ekipi me përvojë, duke patur gjithmonë si synim klientin e kënaqur. Ne vazhdojmë të investojmë në praktikën moderne të biznesit dhe teknikat e menaxhimit në mënyrë që të vazhdojmë të mbajmë pozicionin tonë në treg.



Reputacioni i kompanisë vazhdon të rritet ndërkohë që stafi ynë fokusohet tek implementimi i risive dhe inovacioneve.

Ashtu siç ka përqaftuar inovacionin dhe teknologjinë në ndërtim, FMI gjithashtu ka vendosur të bëhet sa më e pavarur. Sot, kompania zotëron të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e projekteve, përveç kësaj, ajo tregton të gjitha materialet e ndërtimit, duke pasur në këtë mënyrë një rezervë të konsiderueshme të materialeve ndërtimore të cilat janë në dispozicion të projekteve të reja në çdo moment.

QASJA NDAJ BIZNESIT



QASJA NDAJ BIZNESIT

FMI është themeluar duke patur gjithmonë ndërmend natyrën dhe specifikat e fushës ku po operon. Një firmë ndërtimi në thelb ka nevojë të drejtojë tre aktivitete njëkohësisht për të qenë e suksesshme, dhe ato janë:



Marrëdhënia me klientët




Menaxhimi i projekteve



Ekzekutimi i çdo detyre me profesionalizëm

Balanca në kompaninë tonë ruhet duke punuar njëkohësisht në fushat e përmendura më sipër, me synimin e ndërtimit të një avantazhi të fortë konkurrues. Në themel të biznesit tonë qëndron një menaxhim cilësor që shërben si mbështetje për çdo hallkë të ekzekutimit të projekteve. Një tjetër vlerë shumë e rëndësishme e qasjes tonë ndaj biznesit është pavarësia që kemi krijuar dhe kontrolli i cilësisë. Që në fillimet tona ne kemi punuar drejt këtij synimi dhe sot ne tregëtojmë të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit, në këtë mënyrë kemi gjithmonë stock të mjaftueshëm për çdo projekt që na paraqitet, si dhe në ndërtimet tona përdoren gjithmone materiale cilësore dhe të kontrolluara.



FMI

Trade & Construction



VIZIONI DHE VLERAT

Ne besojmë fort në marrëdhëniet njerëzore dhe punojmë me integritet dhe ndershmëri. Ky besim na ka çuar në krye të industrisë së ndërtimit dhe do të vazhdojmë ashtu siç kemi filluar me qëllim që të ndërtojmë projekte dhe infrastruktura të mëdha që do të kontribuojnë për një Shqipëri më të mirë, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Vlerat bazë:

- *Siguria në rradhë të parë*
- *Fokusimi tek nevojat e klientit*
- *Të ofrojmë zgjidhje të personalizuar*
- *Shërbim cilësor dhe të qëndrueshëm*
- *Miqësorë ndaj mjedisit*
- *Pasion për të sjellë ide të reja, inovative dhe të qëndrueshme për klientët tanë*
- *Integriteti, ndershmëria dhe të besueshëm*
- *Standarde të larta etike*
- *Stafi i duhur për çdo punë*
- *Bashkëpunim në grup*
- *Transformimi i objekteve ku ne punojmë*

MISIONI DHE QËLLIMET TONA

Ne ndërmarrim veprime të përditshme drejt përsosjes, për të ndërtuar marrëdhënie më të mira me klientët tanë dhe për formimin e një praktike biznesi më të mirë. Ndërtojmë infrastruktura të qëndrueshme dhe të forta që i rezistojnë kohës, e bëjmë këtë me qëllim që të kemi klientë të kënaqur por dhe për të lënë trashëgiminë tonë.

OBJEKTIVAT NDAJ KONSUMATORIT:

- *Klientë vazhdimisht të kënaqur*
- *Të ndërtojmë një reputacion*
- *Të kuptojmë nevojat dhe pritshmëritë e klientit*
- *Komunikim sa më i mirë me klientët*
- *Rritja kënaqësisë së klientëve përmes përmirësimeve të vazhdueshme në metodat e ndërtimit dhe administrimit të biznesit*

OBJEKTIVAT ORIENTUAR PROCESIT TË BRENDSHËM:

- *Të dorëzojmë çdo projekt në kohë*
- *Përmirësimi i rregullave të shëndetit, sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit*
- *Të përmirësojmë produktivitetin*
- *Të krijojmë procedura të dokumentuara brenda kompanisë*
- *Të zhvillojmë aftësitë dhe kompetencat tona*

FILOZOFIA

Marrëdhëniet e qëndrueshme janë thelbi i biznesit në industrinë ku ne operojmë. Në çdo kohë, ne përpiqemi të sjellim zgjidhje që i përmbushin më së miri nevojat dhe qëllimet e klientëve tanë. Aftësia dhe angazhimi i stafit tonë për të gjetur këto zgjidhje është ajo që na dallon në treg. Gjithashtu, ne i kushtojmë vëmendje të vazhdueshme dhe individuale secilit klient.

Ndikimi në mjedis

Ne jemi të përkushtuar ndaj mbajtjes së mjedisit të pastër dhe besojmë se kjo do të na aftësojë më tej për të funksionuar në mënyrë të disiplinuar dhe të qëndrueshme për një periudhë afatgjatë, fakt i cili ndikon pozitivisht si avantazh konkurrues. Në Shqipëri koncepti i ruajtjes së mjedisit është diçka e re, por sidomos në industrinë e ndërtimit është më e vështirë për t'u zbatuar, megjithatë ne kemi filluar me hapa të vegjël drejt një plani afatgjatë.

Gjurma gjeografike

Fmi Trade & Construction sh.p.k është e vendosur në Tiranë, por jemi duke mbuluar një territor më të gjërë dita-ditës. Projektet tona janë kryesisht në rajonin e Tiranës dhe Durrësit, por kemi potencialin për të ofruar projekte në të gjithë Shqipërinë. Ne mund të punojmë kudo duke u kuptuar dhe u përshtatur me kushtet lokale sociale dhe natyrore, duke menaxhuar në mënyrë efektive të gjitha rreziqet; duke përmbushur afatet dhe kriteret e cilësisë, pavarësisht nga sfidat.

Cilësi nga fillimi në fund

Ne nuk ofrojmë asgjë më shumë se sa punë cilësore. Ne e duam punën tonë dhe e bëjmë atë mënyrën më të mirë të mundshme. Çdo projekt egzekutohet prej nesh kalon nëpër disa faza të vlerësimit dhe mbikëqyrjes, si dhe kemi njohuri të thelluara për materialet që përdorim (negjithashtu i tregtojmë ato). Ndërsa kompanitë me të cilat bashkëpunojmë, prodhojnë vetëm materiale që krijojnë ndërtesa të forta dhe të qëndrueshme.

Çdo punonjës i yni merr krenari personale në çdo projekt të përfunduar, duke u përpjekur që gjithmonë të tejkalojë pritshmëritë e klientit. Stafi ynë është veçanërisht i aftë për perceptimin e shpejtë të vizionit të projektit, për të zhvilluar rast pas rasti metodologjinë më efektive në mënyrë që t'u ofrojmë klientëve tanë paketën më të plotë të mundshme.

Më e rëndësishmja, ne jemi të vendosur të bëhemi një firmë ndërtimi "premium", duke u zhvilluar si ofrues zgjidhjeje për çdo situatë. Një kompani që përdor përvojat e grumbulluara nga projekte të ndryshme për të ofruar vlerë të shtuar për klientët tanë.

SHËRBIMET

▪ Punime ndërtimore

- *Beton arme*
- *Muraturë tulle*
- *Suvatime tradicionale dhe me bazë gipsi*
- *Shtresa niveluese*
- *Shtresa betoni industrial dhe stampime*

▪ Konstruksione metalike

- *Ndërtim kapanonësh*
- *Ndarje kati*
- *Punime kangjellash*

▪ HIDROIZOLIME me material katrama, dy komponentësh me rrjetë dhe bojë me bazë PU

- *Tarracë*
- *Banjo*
- *Ballkone*
- *Bodrume*
- *Veranda*
- *Pishina*

▪ TERMOIZOLIME me materiale polistiren XPS. Polisterol me densitet të ndryshëm. Lesh guri me densitet të ndryshëm

- *Fasada*
- *Tarraca*
- *Cati*
- *Bodrume*

▪ Punime gipsi të brendshme dhe të jashtme

- *Mure ndarës*
- *Veshje dhe maskime kollonash*
- *Tavane të varura*
- *Punime të jashtme me çimentato (Aquapanel)*

▪ Punime rifiniturë

- *Patinime*
- *Lyerje*
- *Letër murale*
- *Bojra deko*
- *Shtrime pllakash*
- *Mermer*
- *Granit*

▪ Sisteme elektrike


- *Punime hidraulike*
- *Sisteme kondicionimi dhe aspirimi*

PROJEKTET TONA

Ne kemi një portofol të gjerë projektesh të përfunduara me sukses. Kemi ndërtuar reputacionin tonë me në fokus klientët tanë dhe qasjen pro-aktive ndaj biznesit. Jemi krenarë për faktin se pjesa më e madhe e klientëve tanë rikthehen për bashkëpunime të mëtejshme pas ekzekutimit të besueshëm të të gjitha projekteve të ndërmarra. Disa nga projektet tona më të rëndësishme janë:



Vip Entrance - Mother Theresa Airport



Kosmonte Foods



Hotel Grand




Volvo Showroom



Eglo Teoren Showroom



Bar Restaurant Müstela



Pharmaceutical Warehouse Noval




Conad - Super market chain



Eco Market - Super market chain

PRODUKTET TONA


Kompania jonë operon gjithashtu dhe në fushën e tregtisë. Tregtojmë të gjitha llojet e veglave të punës dhe materialeve të ndërtimit duke importuar direkt nga fabrikat me licencë ndërkombëtare, si: pambuk mineral **IZOCAM** dhe **ISOVER**, **XPS FIBRAN**, pllaka dhe aksesore **KNUF** dhe **RIGIPS**, ngjyra ekologjike **VECHRO**, **VIVECHROM**, **CAF ITALIA**, materiale hidroizoluese, **ARDEC AUSTRIA**, **ISOMAT**, **INDEX** katrama, etj ... Ne operojmë me furnitorë të ndryshëm Brenda dhe jashtë vendit, si: **Dast**, **Dekoll**, **Izoterm**, **Makita**, **Europofil**, **Izopack Austria**, etj.




HUMAN RESOURCES

FMI Trade & Construction u krijua nga z. Flamur Ibrahim, i cili ka 23 vjet eksperiencë në fushën e ndërtimit, dhe gjatë këtyre viteve ka punuar në projekte të mëdha si: Parku i Qytetit, Hotel Adriatik në Durrës, Blue Star Centre, QTU, Brunes Qeramika, Volksëagen, Tirana East Gate, Ambasador 1, Hotel Continental në Vorë etj. Duke patur në CV-në e tij disa nga projektet më të rëndësishme në Shqipëri, Z. Ibrahim ka ndarë me punëmarrësit e tij gjithë përvojën si mësipër, ashtu dhe disa nga praktikatat më të mira në fushën e ndërtimit. Ne si kompani, përpiqemi gjithmonë të arrijmë më të mirën, të njëjtën gjë kërkojmë dhe nga stafi ynë. Çdo anëtar përzgjidhet me kujdes nëpërmjet niveleve të shumëfishta të përzgjedhjes dhe trajnohet më tej. Sot, çdo anëtar i stafit tonë ka aftësi dhe teknika thelbësore që i implementojnë në Procesin e Ndërtimit.


STAFI YNË





FMI

Trade & Construction



KONTAKTE

info@fmi.al

+355 68 204 6316

www.fmi.al

Rruga 29 Nëntori, Autostrada Tirane-Durres,
km1 (rruga dytesore), Tirana, Albania